



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 22, datë 22.04.2022

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORË PËR VITIN 2022, NGA DATA 20 PRILL 2022 NË DATËN 31 MAJ 2022 PËR SHKAK TË RRIJTJES SË KOSTOVE TË KARBURANTIT DHE SHPENZIMEVE TË TJERA

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore ” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2009 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 160, datë 23.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022, nga data 20 Prill 2022, në datën 31 Maj 2022 për shkak të rritjes së kostove të karburantit dhe shpenzimeve të tjera.
2. Tarifa e plazheve private do të vijojë të paguhet brenda afatit 20 Prill 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Durrës.



Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.04.2022




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 381 / prot.

Durrës, më 05 05 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.22 datë 22.04.2022 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022, nga data 20 Prill 2022 në datën 31 Maj 2022 për shkak të rritjes së kostove të karburantit dhe shpenzimeve të tjera”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

